



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 14 Prot.

Tiranë, më 22/07/2020

VENDIM

Nr. 10, Datë 22/07/2020

**“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË DORËHEQJES, TË PROF. ASC. ELIDA RAPTI,  
NGA KANDIDATURA PËR ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; urdhrave të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë” (i ndryshuar); me nr. 108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga pandemia e COVID-19”, me nr. 175, datë 30.06.2020 “Zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL-të Publike në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me vendim të Senatit Akademik, nr. 19, datë 10.02.2020, si dhe të kërkesës së Prof. Asc. Elida Rapti me nr. 644/1 prot., datë 20.07.2020, në mbledhjen e datës 22.07.2020, pasi diskutoi, me votim të hapur,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së dorëheqjes së Prof. Asc. Elida Rapti me nr. 644/1 prot., datë 20.07.2020.
2. Heqjen e emrit të Prof. Asc. Elida Rapti, nga lista emërore e kandidaturave të shpallura për anëtar të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, të miratuar me Vendimin e Komisionit Institucional Zgjedhor nr. 5, datë 11.05.2020.
3. Ky vendim të dërgohet pranë Komisionit Zgjedhor në Fakultetin e Artit Skenik, Administratores të UART dhe Prof. Asc. Elida Rapti.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike të Universitetit të Arteve dhe pranë këndit zgjedhor në Fakultetin e Artit Skenik.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë**

Ergys Krisiko

Anëtar

Orges Malaj

Anëtar

Ted Kamberi

Anëtar

Albjon Begaj

Anëtar

Suela Agolli

Kryetar

Sekretar: Armira Kapxhiu

